

AKT THEMELIMI

I

SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Project Wear Italy” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

Z. Nicola Sellitri, shtetas Italian, i datëlindjes 18/05/1967, lindur në Andria, banues në Andria; Rruga Pietro D’andria 63, Andri, (BT), Itali; madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i pasaportes me nr YA9246528.

Pjesa e përgjithshme

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 12/06/2023 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

NENI 1

Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “Project Wear Italy”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 2

Forma

Shoqëria tregtare “Project Wear Italy”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 3

Zyra Qëndrore

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “Project Wear Italy”, do të ketë seline e saj qëndrore në: Durres, Lagjja nr.14, Shkozet, me Nr.Pasurie 1/801, Vol.37, Zona Kadastrale 8515.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë: Ne fushen e prodhimit: Prodhim dhe tregtim të konfeksioneve në përgjithësi për burra, gra e fëmijë, me stoffa natyrore ose sintetike, lekure ose të ngjashme, me lende të para nga importi, për llogari të porositesit dhe rieksporimit të produkteve të gatshme. Përgatitja e pjesëve të konfeksioneve, si prerja qepja, ambalazhimi dhe punime të tjera në të lende të para nga importi, për llogari të porositesit dhe rieksporimit të produkteve gjysem të gatshme.

Ne fushen e tregtise: Tregetimin, import-eksport te mallrave ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, veshmbathje, kepuce, hidrosanitare, pajisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, materiale ndertimi, lende te pra per industrine, pjese kembimi auto, kancelari, mobilje, orendi shtepiake, pajisje zyresh, kimikate per bujqesine automjete te llojeve te ndryshme. Aktivitet imobiliar: Blerja e pasurive te paluajtshme (troje, godina, magazine etj.) rikonstruksioni I tyre, me qellim rishitjen apo dhenien me qira etj. Shoqëria, sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë te pakufizuar.

NENI 6

Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit

Shoqëria tregtare "Project Wear Italy" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

NENI 7

Përgjegjësia e Ortakëve

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "Project Wear Italy" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

NENI 8

Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Project Wear Italy" SHPK është 50.000 (pesedhjetemije) Leke, e ndarë në 1 kuotë, i cili është nënshkruar nga ortaku i vetëm.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Z. Nicolla Sellitri është ortaku i vetëm i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, të barabartë me 100% të kapitalit të shoqërisë.

NENI 9

Organet e shoqërisë

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

NENI 10

Administratori

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. Nicola Sellitri.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.

ORTAKËT THEMELUES


Z. Nicola Sellitri
DURRES 12/06/2023